

---

# Pranvera e rimëkëmbjes – niveli i zbatimit, sfidat dhe mundësitë

---

**Analizë Politikash**

---

05/2021



# Pranvera e rimëkëmbjes – niveli i zbatimit, sfidat dhe mundësitë

---

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Qeverisje Demokratike**

Publikimi: **Qershor, 2021**

Foto e ballinës: **Pexels**



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development

## Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



Fondacioni i Kosovës  
për Shoqëri të Hapur

Programi i INDEP për Qeverisje Demokratik mbështetet nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur. Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

---

## **Përmbajtja**

Hyrje.....	2
Metodologjia .....	2
Ligji për Rimëkëmbjen dhe niveli i zbatimit .....	3
Përfitimet për bujqit.....	4
Përfitimet për prodhuesit vendor.....	5
Përfitimet për gastronominë.....	5
Masat që nuk janë zbatuar ende .....	6
Pakoja e shpejtë .....	7
Përfundime .....	9
Rekomandime .....	11

## Hyrje

Efektet e shkaktuara nga pandemia COVID-19 po vazhdojnë të jenë prezente ende në shoqërinë tonë. Edhe pas në më shumë se një vit nga koha kur kjo pandemi u shfaq, dëmet që i ka shkaktuar në jetën sociale dhe atë ekonomike po ndikojnë në zhvillimet globale. Ky ndikim patjetër se është i pranishëm edhe në Kosovë.

Zhvillimi ekonomik i vendit tonë filloi rimëkëmbjen pas betejës që e kishte me pandeminë. Kjo rimëkëmbje u ndihmua edhe përmes pakove të përgatitura nga Qeveria e Kosovës e cila si synim kryesor të saj e kishte rimëkëmbjen e vendit pas goditjes që e kishte. Shumica e masave që u përcaktuan përmes këtyre pakove, filluan zbatimin menjëherë pas miratimit të tyre. Ndërsa disa të tjera edhe pas gjashtë muajve të miratimit të tyre, ende nuk gjetën zbatim në fushat për të cilat ishin përcaktuar.

Masat e përfshira sidomos në këto pako, e sidomos masat e përfshira në Pakon e Rimëkëmbjes, jo të gjitha kanë gjetur zbatim. Këto masa, në shumë raste nuk përfshirë në agjendën e hisedarëve të Kosovës, e le më që të fillojnë zbatimin e tyre. Madje, për disa nga këto masa, nuk janë përfshirë as në buxhetin e miratuar për vitin 2021.

Zbatimi i masave të parapara me Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike ka hasur në pengesa të cilat kanë ndikuar në funksionalizmin e tyre. Pakoja e fundit e cila u miratua gjatë prillit 2021, u shënuar edhe si fillimi i zbatimit të Nenit 11 të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. Kjo pasiqë filloi faza e parë e mbështetjes së sektorit të gastronomisë e që pritet që këto hapa të vazhdojnë zbatimin e këtij Ligji edhe në vijim.

## Metodologjia

Për hartimin e këtij punimi është përdorur metodologji e përzier, kuantitative dhe kualitative. Në pjesën ku është përdorur hulumtimi kuantitativ, INDEP përmes metodës së monitorimit dhe hulumtimit në tavolinë ka mbledhur të dhëna dhe informata rreth hapave të zbatimit të Pakos së Rimëkëmbjes. Krahas kësaj në mënyrë që ky raport të jetë sa më i plotë, INDEP ka plotësuar gamën e informatave kuantitative edhe përmes hulumtimit kualitativ.

Punimi është realizuar në kornizën e procesit të monitorimit të Pakos së Rimëkëmbjes, pra është kulminim i tre buletineve informuese dhe inforgafikave të radhës të cilët kanë për qëllim informimin e qytetarëve rreth zbatimit të masave. Për realizimin e këtyre buletineve, INDEP ka zhvilluar edhe intervista të pastrukturuara me akter institucional përfshirë këtu Ministrinë e Financave, Departamentin e Thesarit të Kosovës, përfaqësues nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), dhe përfaqësues nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), sidhe me përfaqësues nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës. Këto takime kanë shërbyer për të thëlluar informatat dhe dijen dhe përveç pyetjes “sa”, t’u përgjigjemi edhe pyetjeve “si” dhe “në ç’mënyrë”.

Pas mbledhjes së të dhënave, analiza e të dhënave ka kaluar në dy faza kryesore. Në fazën e parë, në kemi sistemuar të dhënat dhe i kemi bërë një analizë të përmbajtjes. Në pjesën e dytë ne kemi tabuluar të dhënat nga hulumtimi kuantitativ me përfundimet e nxjerra nga intervistat për të nxjerrë qëndrimet përfundimtare. Në fund, hulumtimi ka kaluar edhe nëpër një analizë të përgjithshme

të kontekstit zhvillimor të Kosovës ku edhe kemi përshtatur disa nga përfundimet me aktualitetin ekonomik dhe politik të vendit.

## Ligji për Rimëkëmbjen dhe niveli i zbatimit

Pandemia COVID-19 përpos problemeve dhe krizave shëndetësore, ka shkaktuar dëme dhe kriza të mëdha në aspektin ekonomik në të gjitha vendet e botës. Për të parandaluar krizat e mëtejme shumë shtete, duke përfshirë edhe Republikën e Kosovës, kanë hartuar Pakot e Rimëkëmbjes Ekonomike. Këto pako kanë për qëllim ofrimin e ndihmës për sektorin ekonomik. Në hap me vendet e tjera, edhe shteti ynë ka miratuar Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike me qëllimin e ofrimit të lehtësimeve dhe ndihmave për të dëmtuarit nga pandemia globale COVID-19.

Me 7 Dhjetor të vitit 2020, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës miratoi Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike – COVID-19.<sup>1</sup> Ky ligj ka për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve të tjera, dhe e gjithë kjo me qëllimin e rimëkëmbjes ekonomike të Republikës së Kosovës, pas dëmeve dhe problemeve që i ka shkaktuar pandemia COVID-19. Ky ligj ka paraparë ndihma për shumicën e bizneseve dhe përfituesit do të jenë vet qytetarët e Republikës së Kosovës, me forma të ndryshme të ndihmave që do të aplikohen në bazë të këtij ligji.

Duke pasur synim kryesor revitalizimin e ekonomisë kosovare, Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike ka një numër objektivash të cilat kanë filluar të zbatohen, por jo plotësisht. Disa nga këta objektiva të cilat parashihen të arrihen përmes këtij ligji janë:

- 212 mil.€ nga Trusti Pensional, që do të jenë në dispozicion të qytetarëve për tërheqje pa pasur nevojë të paguajnë tatim
- 200 mil.€ përkrahje për bizneset, që është parashikuar të mbulojë shpenzimet operative për bizneset të cilat kanë qenë të mbyllura apo kanë pasur problem që të funksionojnë normalisht gjatë kohës së pandemisë COVID-19
- 20 mil.€ për punëtorët që kanë humbur vendet e tyre të punës si pasojë e pandemisë COVID-19
- 0% TVSH për lëndën e parë të prodhuar në territorin e Republikës së Kosovës
- 0% rentë minerare dhe tarifë për energjinë e ripërtrishme

Këto pika të lartpërmendura paraqesin disa nga objektivat apo qëllimet të cilat i përmban në vete Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike, por jo të gjitha janë zbatuar.

Ndër masat që ka gjetur zbatim më së shumti me miratimin e këtij Ligji është mundësia e tërheqjes së 10% të kursimeve pensionale nga Fondi Pensional i Kosovës. Qytetarët kanë pasur mundësinë e aplikimit për tërheqjen e kësaj përqindje nga kursimet e tyre pensionale, prej datës 11 Dhjetor 2020 deri me datë 6 Prill 2021. Kjo masë u zbatua plotësisht dhe ka ndihmuar qytetarët për të tejkaluar më lehtë krizat financiare dhe problemet tjera që solli pas vetes pandemia globale COVID-19.

---

<sup>1</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 07, Dhjetor 2020, Prishtinë, Faqe 1, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=35478>, (E qasur në Maj, 2021)

Ndërsa masa e cila nuk filloi zbatimimin është përkrahja për bizneset në vlerë prej 200 mil.€. Edhe pse ka pasur përkrahje të vazhdueshme të bizneseve nga ana e Qeverisë, shuma prej 200 milion euro nuk është paraparë edhe në planifikimin e buxhetit për vitin 2021. Kjo pasiqë për këtë sektor në total janë të dedikuara 222.4 milion euro. Kjo shumë do të shpërndahet nëpër disa kategori dhe nuk është e mundur që të përmbushet objektivi i cili ndihmon bizneset në vlerën prej 200 mil.€, e i cili është pjesë e Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. Por pritet që Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike të sjellë rezultate të plota në mbështetjen e ekonomisë së dëmtuar nga pandemia COVID-19.

## **Përfitimet për bujqit**

Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike përfshin ndihma dhe lehtësime edhe për sektorin e bujqësisë. Ky ligj parasheh që të rrit përqindjen e mbulesës kreditore për garancitë kreditore nga 50% në 80%. Garancia kreditore e FKGK-së është garanci për të ndarë rrezikun me institucionet partnere financiare për kreditë e ndërmarrjeve mikro, të vogla, dhe të mesme. Këtu përfshihen edhe agrobizneset të cilat përmes kësaj mase e kanë më të lehtësuar rimëkëmbjen e tyre ekonomik. Bujqit janë një kategori mjaft e prekur nga pandemia COVID-19, dhe duke e ditur rëndësinë e tyre, ofrimi i ndihmave për të lehtësuar gjendjen e tyre është i domosdoshëm.

Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike përmes nenit Neni 7- Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar ka përfshirë mbështetjen e prodhuesve vendorë. Përmes këtij neni, Qeveria ofron përkrahje për prodhuesit vendorë me qëllim rimëkëmbjen ekonomike të vendit e cila pësoi rënie nga pandemia COVID – 19 duke larguar kështu TVSH-në për transaksionet e sigurimit dhe ri-sigurimit në bujqësi, për policat e sigurimeve bujqësore për kulturat bujqësore në Kosovë. Këto ndihma janë të mirëseardhura nga ana e bujqve, pasi që është një shtyrje drejt kalimit të krizës së shkaktuar në glob.

Neni 7 për ndryshimet në TVSH, në paragrafin 2 thekson:

2. Neni 28 i LTVSH-së, pas nën-paragrafit 1.12. shtohet një nën-paragraf i ri, me numrin rendor 1.13., me tekstin si në vijim:

1.13. transaksionet e sigurimit dhe ri-sigurimit në bujqësi, për policat e sigurimeve bujqësore për kulturat bujqësore në kriteret që përcaktohen me vendim nga Ministri i Bujqësisë. Me qëllim të zbatimit të këtij ligji, Ministri i Financave me vendim përcakton procedurat dhe kriteret.<sup>2</sup>

Përmes këtij neni, Qeveria e Kosovës sqaron se të gjithë personat e regjistruar për të paguar Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), për transaksionet e sigurimit dhe ato të ri-sigurimit në bujqësi, si dhe për policat e sigurimeve bujqësore për kulturat bujqësore që kultivohen në Kosovë nuk do të aplikohet TVSH për ta. Kjo mundësi mund të shfrytëzohet me kusht që të kenë plotësuar kriteret të cilat janë përcaktuar nga Ministria e Bujqësisë.

Ndonëse fermerët janë mësuar të përshtaten me rrethanat, qofshin thatësira, përmytje apo infektive të ndryshme. Kapërcimi i pengesave të paparashikueshme shkon me punën e tyre, por

---

<sup>2</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 07, Dhjetor 2020, Prishtinë, Faqe 4, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=35478>, (E qasur në Maj, 2021)

pandemia COVID-19 po sjell një sërë sfidash të reja në rritjen e ushqimit nga i cili varen njerëzit. Këto sfida e bëjnë të qartë se duhet kryer më shumë për të ndihmuar fermerët që të vazhdojnë punën e tyre, e cila është në dobi të secilit. Momentalisht është e pamundur të parashikohet se cilat do të jenë pasojat afatgjata të pandemisë COVID-19. Duke llogaritur humbjet dhe problemet që kanë ardhur deri tani si pasojë e pandemisë COVID-19, është e nevojshme që të zhvillohen strategji dhe të maten efektet e pandemisë.

## **Përfitimet për prodhuesit vendor**

Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike u ofron ndihmë edhe prodhuesve vendor. Duke e ditur se mbyllja totale për një kohë, e pastaj edhe kufizimet tjera, kanë ndikuar edhe tek kjo kategori, ka qenë e domosdoshme që të kenë përfitime financiare dhe lehtësime tjera të cilat shtyejnë drejt rikthimit të normalitetit. Prodhuesit vendor janë aset i rëndësishëm i ekonomisë së Republikës së Kosovës, dhe për këtë arsye kanë privilegje edhe në Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike. Saktësisht kjo kategori trajtohet në Nenin 13 të këtij ligji.

Neni 13, i Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike parasheh përparësinë e prodhuesve të produkteve gjatë vlerësimit të ofertave.<sup>3</sup> Ky nen thekson:

1. Gjatë vlerësimit të ofertave, të cilat janë dorëzuar nga prodhuesit e produkteve dhe shërbimeve vendore, kontratave të furnizimit për punë apo ofertuesve vendor, që në ofertë përmbajnë vetëm produkte dhe shërbime vendore, do t'i jepet përparësi krahas ofertave të ofertuesve me produkte dhe shërbime të huaja, në rast se diferenca në mes të këtyre ofertave nuk është më e lartë se dhjetë pikë.
2. Në rast se kriteri për dhënie të kontratës është çmimi i ulët, atëherë i jepet preferencë ofertuesit vendorë me produkte dhe shërbime vendore, në rast se çmimi i po të njëjtës nuk është më i lartë se pesëmbëdhjetë përqind në krahasim me ofertën e ofertuesit të huaj.

Ky nen është në favor të gjithë prodhuesve vendor, dhe sado pak inkurajon dhe ndihmon ata që të kalojnë pasojat e pandemisë COVID-19 më lehtë.

Neni 13 i këtij ligji ofron përparësi për prodhuesit vendor kunddrejt ofertuesve apo prodhuesve të jashtëm. Kjo masë do të zbatohet pas paraqitjes së ofertimit, në rastin kur diferenca mes prodhuesve vendor dhe atyre të jashtëm, nuk është më e madhe se 10 pikë. Një pikë e tillë është e mirëseardhur nga ana e prodhuesve vendor, pasi që ndihmon ata në një masë që të rivitalizojnë bizneset e tyre dhe në të njëjtën kohë të plotësojnë kërkesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Prodhuesit vendor janë kategori e rëndësishme e ekonomisë së vendit tonë, dhe mos përfshirja e tyre në këtë ligj, do të ishte në dëm të secilit prej nesh.

## **Përfitimet për gastronominë**

---

<sup>3</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 07, Dhjetor 2020, Prishtinë, Faqe 5, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=35478>, (E qasur në Maj, 2021)



Një nga masat parandaluese rreth përhapjes së pandemisë, ka qenë dhe është distancimi social. Me mbylljet totale e pastaj edhe ato të pjesshme që ndodhën në vendin tonë, një nga sektoret më të prekura ka qenë sektori i gastronomisë. Si pasojë e këtyre masave parandaluese të përhapjes së pandemisë COVID-19, shumë punëtorë të sektorit të gastronomisë kanë humbur vendet e tyre të punës, ndërsa pronarët e bizneseve të gastronomisë kishin humbje të mëdha ekonomike dhe dëme të cilat do të vërehen për shumë kohë. Ndërsa Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike nuk kishte si të mos përfshinte këtë sektor, në aspektin e ndihmave dhe lehtësimeve.

Në këtë ligj, përkatësisht në Nenin 7, theksohet ndihma e cila do t'i ofrohet sektorit të gastronomisë. Ky nen, i quajtur Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr.05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar<sup>4</sup>, thekson që:

1. Neni 26 i Ligjit Nr.05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (këtu e tutje LTVSH), pas nën-paragrafit 2.13. shtohet një nën-paragraf i ri, me numrin rendor 2.14., me tekstin si në vijim:

2.14. furnizimet e hoteleve, restoranteve dhe shërbimet e ushqimit

Ky nen zvogëlon Tatimin mbi Vlerën e Shtuar nga 18% sa ka qenë më herët, në 8%. Të drejtë zbatimi të uljes së TVSH-së kanë të gjithë qytetarët e Kosovës të cilët janë të regjistruar për pagesat mbi TVSH dhe që këto blerje të mallërave dhe shërbimeve i shfrytëzojnë për qëllim të realizimit të furnizimeve hoteliere, restoranteve dhe shërbimeve të ushqimit.

Në periudhën e pandemisë COVID-19, nuk ka dyshime për sa i përket sektorit më të prekur, e i cili është ai i gastronomisë. Akumulimi i borxheve, pagesa e qirave, rimbursimi i punëtorëve, ratat e kredive, e shumë faktorë tjerë kanë ndikuar që dëmet të jenë të mëdha. Shumë biznese të këtij sektori janë mbyllur si pasojë e shumave të mëdha të borxheve por edhe humbjes së punëtorve. Lehtësimi tatimor ka qenë i mirëpritur nga i gjithë sektori dhe masa e tillë sado pak ka ndihmuar ata që të kalojnë këtë krizë globale më lehtë.

## **Masat që nuk janë zbatuar ende**

Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike përmban nene të cilat ende deri më sot nuk kanë filluar të zbatohen. Janë dy nene të cilat për nga rëndësia janë esenciale, pasi që do të ishin ndihmesë e madhe për qytetarët e Republikës së Kosovës. Duke i parë vështirësitë ekonomike, shëndetësore dhe sociale, aplikimi në tërësi i Ligjit për Rimëkëmbje do të sillte më pak vështirësi në rivitalizimin e këtyre qështjeve për të gjithë bizneset dhe qytetarët. Zotimet e bëra nga ana e Qeverisë duhet të jenë në linjë me nenet dhe në të njejtën kohë edhe të aplikohen që të rikthehet normaliteti.

Neni 11 i Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike quhet Përkrahja e Ndërmarrjeve private. Tutje, ky nen citon se:

1. Të gjitha bizneset të cilat kanë qenë të mbyllura apo kanë pasur problem të funksionimit të rregullt gjatë kohës së pandemisë, por të cilat kanë qenë aktive në regjistrë të Administratës Tatimore të Kosovës, para datës 29 shkurt 2020,

---

<sup>4</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 07, Dhjetor 2020, Prishtinë, Faqe 3, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=35478>, (E qasur në Maj, 2021)



mbështeten financiarisht nga ana e buxhetit të Republikës së Kosovës me mjete monetare për t'i mbuluar shpenzimet operative në shumën prej dyqin milion euro (200,000,000 euro).<sup>5</sup>

Kjo masë ka filluar zbatimin përmes Pakos së shpejtë. Pëmes kësaj pakoje ka filluar zbatimi i këtij neni, ku si përfitues kryesor janë rreth 400 biznese. Prej kësaj pakoje janë shfrytëzuar rreth 60 milion euro, mirëpo duke parë premtimet që janë bërë, dhe me fokus të posaqëm për këtë nen, implementimi i tij i tërësishëm duhet të bëhet sa më shpejtë, pasi që do të ndihmonte shumë bizneset dhe të gjithë qytetarët. Por ky nuk është neni i vetëm që Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike nuk e ka zbatuar ende tërësisht edhe pse një pjesë e mjeteve janë ndarë për këtë pikë.

Neni 12 i Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike quhet Pagat e punëtorëve në sektorin privat. Tutje, ky nen citon se:

1. Paguhën, nga ana e Buxhetit të Republikës së Kosovës, pagat e punonjësve në sektorin privat për periudhën tetot-dhjetor 2020 të cilët si pasojë e pandemisë COVID-19, janë larguar apo pezulluar nga puna e tyre për periudhën jo më të shkurtër se tre(3) muaj, pas datës 29 shkurt 2020, deri më 30 dhjetor 2020.
2. Shuma e pagesës për punëtorët nga paragrafi i 1. i këtij neni, është treqind euro (300 euro) për një(1) muaj.<sup>6</sup>

Ashtu si neni paraprak, as ky nen nuk është zbatuar deri më sot, e për të cilën shumë punonjës të cilët do të përfitonin nga kjo pikë, ndajnë dëshpërim me të drejtë të plotë. Duke marrë parasysh ndikimet negative, kjo shumë prej treqind euro (300 euro) do të zgjaste dorën e ndihmës sa do pak.

## **Pakoja e shpejtë**

Vendimi Nr. 01/05, i datës 05.04.2021 i Qeverisë së Kosovës<sup>7</sup> ka pezulluar përkohësisht aktivitetet e këtyre shoqërive tregtare:

- Sektori i gastronomisë ka shërbyer vetëm me dërgesa me porosi, “merr me vetë” dhe “drive-through”
- Është ndaluar veprimtaria e qendrave tregtare të mbyllura
- Është ndaluar aktiviteti në hapësira të mbyllura të palestrave dhe fitneseve

Ky vendim u morr për arsye të përhapjes së madhe të infektiveve si pasojë e pandemisë COVID-19 dhe si masë parandaluese e përhapjes së mëtutjeshme, u pa si e nevojshme një vendim i mbylljes së disa aktiviteteve.

Në të njëjtin vendim, Qeveria e Republikës së Kosovës morri edhe vendimin tjetër i cili do të mbështeste këto kategori. Qeveria e Republikës së Kosovës, në bazë të këtij vendimi do të ndante

---

<sup>5</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 07, Dhjetor 2020, Prishtinë, Faqe 5, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=35478>, (E qasur në Maj, 2021)

<sup>6</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 07, Dhjetor 2020, Prishtinë, Faqe 5, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=35478>, (E qasur në Maj, 2021)

<sup>7</sup> Vendimet e Mbledhjes së 7 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, 2021, e qasshme në <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2021/04/Vendimet-e-Mbledhjes-se-7-te-te-Qeverise-se-Republikes-se-Kosoves.pdf>, (E qasur në Maj, 2021)

mjete financiare në vlerë prej 6,000,000 milion euro (gjashtë milion euro). Kategoritë e caktuara të bizneseve mbështetën me mjete financiare të ndara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për:

- Pagat e punëtorëve dhe
- Pagesën e qirasë

Kjo pako e shpejtë ka për qëllim lehtësimin e humbjeve për kohën e mbylljes, ku nëpërmjet këtyre mjeteve financiare, periudha e mbylljes do të ndikonte më pak negativisht.

Për këtë subvencionim kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë tatimpaguesit të cilat kanë pësuar rënie në të hyra për shkak të kufizimeve të vendosura sipas Vendimit Nr. 01/05, të datës 05.04.2021, të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Subvencionimi i pagës së punëtorëve bëhet deri në nivelin 50% të pagës neto të të punësuarve e llogaritur mbi pagën bruto dhe duke qenë i liruar nga tatimi sipas legjislacionit në fuqi, deri në maksimum prej pesëqind euro (500 EUR). Janë disa kategori biznesesh të cilat mund të aplikojnë dhe të përfitojnë nga kjo mbështetje.

Për subvencionim të pagës së punëtorëve mund të aplikojnë këto kategori të bizneseve:

- Bizneset me nën-sektor gastronominë,
- Bizneset që ushtrojnë aktivitetin në qendra tregtare të mbyllura
- Bizneset me hapësira shfrytëzimi për fitnes dhe palestër dhe
- Bizneset me linja aktive të licencuara për transport ndër-urban të udhëtarëve

Këto kategori janë të selektuara si biznese përfituese nga kjo pako, pasi që këto janë të prekurat e masave paraprake që u morrën sipas Vendimit Nr. 01/05, të datës 05.04.2021 nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Kjo pako përfshin ndihma edhe në subvencionimin e qirasë. Subvencionimi i qirasë bëhet në nivelin deri në 50% të qirasë neto, deri në një maksimum prej 2,500 EUR për njësi, për bizneset qiramarrëse duke qenë i liruar nga tatimi. Për subvencionim të qirasë mund të aplikojnë:

- Bizneset me aktivitet të vetëm gastronominë dhe
- Bizneset për njësitë që ushtrojnë aktivitetin në qendra tregtare të mbyllura.


Ndonëse këto ndihma nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës janë të mirëpritura, nuk do të thotë që përfshijnë mbulimin e të gjitha humbjeve që këto mbyllje kanë shkaktuar. Por lehtësimet dhe ndihmesat e tilla janë të nevojshme dhe normalisht të pranueshme nga ana e bizneseve përfituese të kësaj pakoje.

## **Ndikimi i Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike ë zhvillimin ekonomik të vendit në TM3 2021**

Se kanë filluar të ndikojnë masat e Pakos së Rimëkëmbjes, sidomos mund të vërehet ndikimi i këtyre masave të sipërpërmendura, mund ta ilustronjë edhe raportet e nxjerra nga Agjencia Statistikore e Kosovës gjatë muajve janar, shkurt dhe mars të vitit 2021. Bazuar në të dhënat e publikuara nga Agjencia Statistikore e Kosovës, eksporti i mallrave në muajin mars 2021 kishte vlerën 61.8 milionë Euro, ndërsa importi 382.5 milionë Euro, që është një rritje prej 92.2% për eksport dhe 51.8% për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020.

Table 1. Të dhënat lidhur me krabasimin e eksportit dhe importit gjatë TM1 të vitit 2020-2021

Muaj	Eksport 2020	Import 2020	Eksport 2021 (%)	Import 2021 (%)
Janar	28,9 mil	221,2 mil	42,5 mil	235,8 mil
Shkurt	35.9 mil	263.3 mil	48,4 mil	301,7 mil
Mars	32.1 mil	252.0 mil	61.8 mil	382.5 mil



Në bazë të kësaj table, mund të theksojmë se ekonomia e vendit ka filluar rimëkëmbjen e saj dhe se duke pasur parasysh se krahasimet e vlerave të eksportit dhe importit brenda periudhës 2020-2021, vërejmë se jemi duke vazhduar drejt rimëkëmbjes së suksesshme. Edhe pse kjo pako është pakoja e parë që ka për qëllim Rimëkëmbjen ekonomike, ne presim që hisedarët e Kosovës të hartojnë pakot e rradhës të cilat do ndihmojnë në rimëkëmbjen e ekonomisë së vendit e cila pësoi rënie gjatë kohës kur vendi ynë sikurse shumica e vendeve të botës po përballej me pandeminë COVID-19.

### Përfundime

- Rimëkëmbja ekonomike ka filluar me hapa të ngadalët. Dëmet ekonomike dhe krizat e tjera të cilat solli pas vetes pandemia COVID-19 ishin dhe janë të mëdha, dhe rivalizimi i ekonomisë tashmë ka filluar. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, tre mujori i parë i vitit 2021 tregon ngritje të numrave sa i përket eksportit dhe importit të mallrave, në krahasim me tre mujorin e parë të vitit 2020. Pakoja e Rimëkëmbjes ekonomike është e ditur që nuk mund të paraqesë zgjidhje për të gjithë dëmet që ka shkaktuar pandemia COVID-19, por paraqet një ndihmesë për bizneset dhe personat të cilët janë ballafaquar me kriza ekonomike gjatë kësaj periudhe. Hapja graduale e ekonomisë, lirimi i masave parandaluese dhe ndihmat financiare kanë bërë që ekonomia të kthehet gradualisht në normalitet.
- Edhe pse kanë kaluar më shumë se një vit nga shfaqja e rasteve të para të prekura me COVID-19 në vendin tonë, efektet e kësaj pandemie po vazhdojnë të shfaqen ende. Këto

efekte përkthehen në probleme shëndetësore, ekonomike dhe sociale, pasi që dëmet e pandemisë COVID-19 në terme afatgjate nuk dihen as sot. Duke e ditur se me kriza të tilla njerëzimi nuk ballafaqohet vit pas viti, ka qenë e parashikuar se dëmet dhe pasojat e pandemisë do të vëreheshin edhe pas disa kohësh, madje edhe pas shuarjes së saj. Pa dyshim që pas dëmeve shëndetësore, sektori i ekonomisë ka qenë më i prekuri duke shkaktuar për shumë njerëz dëme që vështirë që mund të riparohen. Kjo nënkupton që ndihmat nga shteti ynë kanë qenë të mirëseardhura dhe në të njëjtën kohë kanë pasur efekt, por jo aq sa të mos vërehen dëmet që pandemia COVID-19 solli.

- Masat e parapara me Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike nuk janë zbatuar tërësisht. Ky ligj u soll me bujë të madhe duke ditur që masat që parashihte që të merr ky ligj, ishin fitimprurëse për shumë kategori, e me fokus të theksuar tek rimëkëmbja e ekonomisë sa më shpejtë dhe sa më mirë. Por, këto masa nuk janë zbatuar ashtu sikur se premtohesh, pasi që disa prej tyre ende nuk kanë filluar të zbatohen. Neni 11 i Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike që quhet Përkrahja e Ndërmarrjeve private dhe Neni 12 i Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike që quhet Pagat e punëtorëve në sektorin privat nuk janë zbatuar, ani pse shumë njerëz do të përfitonin. Këto nene janë premtime me rëndësi të madhe dhe implementimi i tyre do të sjellte shumë lehtësime në rivitalizimin e përgjithshëm.
- Gjashtëmuajori i parë nga fillimi i zbatimit të Pakos së Rimëkëmbjes e gjen ende të pazbatuar Nenin 12 të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. Ky nen, nga i cili do të përfitonin punëtorët e sektorit privat, thuhet është një nga nenet kryesore të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. Nga ky nen do të përfitonin nga tre qind euro (300 euro) punëtorët të cilët si pasojë e pandemisë COVID-19, janë larguar apo pezulluar nga puna e tyre për periudhën jo më të shkurtër se tre(3) muaj, pas datës 29 shkurt 2020, deri më 30 dhjetor 2020. Ndonëse ende nuk ka veprim konkret i cili do të shtynte drejt realizimit të këtij neni, shumë punëtorë të cilët do të ishin përfitues të këtyre mjeteve janë në pritje, ku sado pak do të lehtësonin situatën e rënduar që ka shkaktuar pandemia COVID-19.
- Implementimi i nenit 11 ka filluar të gjejë zbatim qysh pas mëse 6 muaj miratimi të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. Neni 11 i Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike i cili quhet Përkrahja e Ndërmarrjeve private, parashihet që të mbështesë bizneset të cilat kanë qenë të mbyllura si pasojë e pandemisë COVID-19, me shumë monedha ëreë dyqind milion euro (200,000,000 euro). Ishte pakoja e shpejtë ajo e cila filloj që të zbatohet këtë nen, i cili ende ka nevojë që të implementohet. Kjo masë parashihet të ketë efekte mjaft pozitive, dhe do të ndihmojë bizneset në tejkalimin e krizave që janë shkaktuar deri më tani.
- Pakoja e shpejtë ka gjetur zbatim në sektorët e përcaktuar. Kjo pako e cila ka ndarë mjete në vlerë prej gjashtë milion eurove (6,000,000 euro), është zbatuar tashmë dhe fokusin kryesor e ka pasur tek sektori i gastronomisë. Një pako e tillë, e cila erdhi si rrjedhojë e mbylljes së masës parandaluese ndaj përhapjes së virusit COVID-19, u prit mjaft mirë pasi që solli lehtësime në humbjet që shkaktoheshin nga mbyllja. Pakoja ofronte mbështetje për pagesat e punëtorëve dhe pagesat e qirave. Krahas me ndihmat tjera, edhe kjo pako e shpejtë nuk përmbushi të gjitha nevojat që u paraqitën dhe ende problemet janë evidente.

## Rekomandime

1. Çfarëdo pako tjetër e rimëkëmbjes në të ardhmen, duhet të dizajnohet duke u konsultuar me institucionet zbatuese, shoqërinë civile dhe vetëm pas një diskutimi të gjerë shoqëror. Përvoja nga monitorimi i këtij Ligji dhe pakos së politikave të rimëkëmbjes kanë treguar që sa më pak të ketë diskutime për një dispozitë të caktuar apo masë të paraparë në ligj, aq më të vogla do të jenë shanset për të pasur implementim të masës. Qeveria e re, duhet të intensifikoj dialogun shoqëror para miratimit të çfarëdo pakoje të re të rimëkëmbjes.
2. Qeveria të krijoj një grup të përbashkët, të përbërë nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme, përfaqësues të bizneseve dhe shoqërisë civile për monitorimin e zbatimit të pakos së rimëkëmbjes. Ky grup do të monitoronte zbatimin dhe do të raportonte në baza të rregullta për progresin në secilën fushë.
3. Një mekanizëm online i monitorimit të zbatimit të pakove të rimëkëmbjes dhe përcjelljes së progresit është i domosdoshëm. Ky mekanizëm do të shërbente për rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe mundësisë për të përmirësuar dhe intervenuar në kualitetin e masave.
4. Pakot e ardhshme të dedikuara për sektorin e bujqësisë duhet të jenë në linjë me nevojat reale të bujqve për më shumë trajnime, më shumë përkrahje me subvencione direkte dhe më shumë kriteret e performancës me rastin e dhënies së granteve.
5. Në pakot e ardhshme të rimëkëmbjes, sektori i gastronomisë të mos përfshihet. Në pakot e deri tanishme, sektori i gastronomisë ka qenë i përfshirë mjaftueshëm dhe sektori si i tillë ka parë këndelljen më të madhe nga pakot e rimëkëmbjes.
6. Para miratimit të çfarëdo pakoje të re, Qeveria të formoj një grup ndër-ministror për zbatimin e masave që nuk kanë gjetur ende zbatim nga Ligji për Pandeminë Covid-19.